



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.751/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci, Ferki Xhaferi dhe Afijte Sada-Gllogjani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Vlora Grajçevci, kandidate për anëtare të Kuvendit të Komunës së Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.751/2021, i Vlora Grajçevci, kandidate për kuvend të Komunës së Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatët për Kuvend Komunal në Obiliq, të Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në këto Vendvotime: 1520E/01R, 1508e/01R, 1520E/02D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet e cituara si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e apelit lidhur me kërkesën për rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet: 1519E/01R, 1519e/02D, 1508e/02D.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021, nga Vlora Grajçevci, kandidate për kuvend të Komunës së Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, në të cilin pretendon se që nga dita e zgjedhjeve e deri në Shpalljen e Rezultateve nga KQZ iu janë anuluar 6 vota. Më tej në apel parashtruesja thekson se votat e familjarëve i mungojnë, dhe kërkon të rinumërohen votat në këto Vendvotime: 1508E/01R, 1508E/02D, 1519E/01R, 1519E/02D dhe 1520E/01R dhe 1520E/02D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Paneli pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë nga ekipi i PZAP-it, më datë 04.11.2021, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjeti se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që në kutinë e votimit 1520e/02D, nga fletëvotimet e vlefshme të rinumëruara del se Vlora Grajçevci, kandidatë për kuvend të Komunës së Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik AAK, ka 3 vota dhe nga fletëvotimet e pavlefshme asnjë fletëvotim nuk kishte të shënuar numrin 6, në kutinë e votimit 1508e/01R, nga fletëvotimet e vlefshme të rinumëruara del se e njëjta ka 7 vota dhe nga fletëvotimet e pavlefshme asnjë fletëvotim nuk kishte të shënuar numrin 6, si dhe në kutinë e votimit 1520E/01R, nga fletëvotimet e vlefshme të rinumëruara del se e njëjta ka 1 votë dhe nga fletëvotimet e pavlefshme asnjë fletëvotim nuk kishte të shënuar numrin 6.

Vet fakti se me verifikim të pretendimeve të ankuesit, në provat e bashkangjitura në apel dhe nga hetimet e kryera në QNR, del se në VV e përmendura në pikën II të dispozitivit ka mungesë të votave të kandidatëve të subjektit politik AAK, ashtu siç pretendohet në apelin e lartpërmendur, gjë që tregon se rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ-ja, vërtetë del i pasaktë, dhe sipas vlerësimit të PZAP-së, është bazë e mjaftueshme për rinumërim ashtu siç është vendosur me këtë vendim. PZAP-i vlerëson se përveç tjerave, me rinumërim, askujt nuk i cenohet rezultati real dhe i vërtetë, përkundrazi për secilin kandidat për kuvend komunal del rezultat zgjedhor më i sigurt dhe i pranueshëm nga të gjithë.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për Kuvend Komunal në Obiliq, në apelin e lartcekur dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, andaj PZAP, nga këto arsye dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Pjesa e apelit e cila u refuzua përkitazi me kërkesën për rinumërim në VV të përmendura në pikë IV të dispozitivit, pasi që sipas hetimit të kryer për Kutinë e Votimit 1519E/01R konstatohet se kandidatja Vlora Grajçevci me nr. rendor 06 nga Subjekti Politik AAK, nga

fletëvotimet e vlefshme të rinumëruara del se e njëjta nuk ka asnjë votë dhe nga fletëvotimet e pavlefshme asnjë fletëvotim nuk kishte të shënuar numrin 6, në kutinë e votimit 1519e/02D konstaton se nga fletëvotimet e vlefshme të rinumëruara e njëjta nuk ka asnjë votë dhe nga fletëvotimet e pavlefshme asnjë fletëvotim nuk kishte të shënuar numrin 6, në kutinë e votimit 1508e/02D, nga fletëvotimet e vlefshme të rinumëruara e njëjta nuk ka asnjë votë dhe nga fletëvotimet e pavlefshme asnjë fletëvotim nuk kishte të shënuar numrin 6,

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Obiliq, për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 751/2021 më datën 05.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.